

## Raport Muaji Mars 2019 për fondin Credins Pension

**Shoqëria Menaxhuese e Fondit:** Credins Invest sh.a.

**Data e lançimit të fondit:** 01 Janar 2012

### Objektivi i investimit

Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t’u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit.

Portofoli i Fondit Credins Pension, do të përbëhet kryesisht nga obligacione afatgjata të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një cilësi jete gjatë pensionit e cila nuk rezulton më e ulët sesa faza përpara daljes në pension.

### Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të ulëta

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi Credins Pension ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

### Të dhëna kryesore për Fondin, në 31 Mars 2019

Vlera Neto e Aseteve	637,266,528.27
Numri i Investitorëve	15,906
Cmimi i kuotës	1,432.1649
Kthimi nga investimi (31.03.2018-31.03.2019)*	4.82%

\* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

### *Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond*

#### Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e riçmimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i riçmimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

#### Obligacionet

Këto asetë janë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, agjensitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme.

### *Kostot dhe Pagesat*

Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

#### **Pagesat e hyrjes dhe daljes nga Fondi**

Pagesa e hyrjes: 0%

Pagesa e daljes: 0%

Pagesat vjetore: Tarifa e Administrimit 3% në vit e Vlerës Neto të Aseteve


Kosto Transaksioni: 0%

Tarifa e performancës: 0%


### *Shpërndarja e Instrumentave si përqindje e Vlerës Neto të Aseteve, në 31 Mars 2019*

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Vlerës Neto të Aseteve
Obligacione	632,121,597	99%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	6,757,067	1%

*Shpërndarja e Instrumentave sipas Llojit, në 31 Mars 2019*



*Kthimi vjetor neto historik, në 31 Mars 2019*



Norma vjetore e kthimit për 12 muajt e fundit ishte 4.82%.




**CREAINS  
INVEST**

*Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit*

Rruga “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3  
Tiranë, Shqipëri  
NIPT: K52311009R  
+355 4 53 51 030  
www.credinsinvest.com

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, duke përjashtuar ankandet e obligacioneve 2-vjeçare të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.

### *Ecuria e yield-eve të Obligacioneve*



Gjatë muajit Mars yield-i i obligacionit me afat maturimi 2 vjet ka shënuar rënie në ankandin e rihapjes, nga 1.79% në 1.55%. Ankandi i zhvilluar për obligacionin 7-vjeçar shënoi rënie nga 5.02% në 3.75%. Ankandi i zhvilluar për obligacionin referencë 5-vjeçar shënoi rezultatin 2.732%. Gjatë muajit Mars nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 3 dhe 10-vjeçare.

*Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni web site e shoqërisë <http://www.credinsinvest.com/>.*